Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias

Udhëzues për zhvillimin e moduleve

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës

Botimi që ju paraqesim, është pjesë e paketës se mjeteve didaktike SCREAM - Ndal Punës së Fëmijëve. SCREAM është shkurtimi i përcaktimit në gjuhën angleze "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias". Kjo paketë është realizuar në kuadër të projektit INT/99/MO6/ITA, financuar nga Qeveria Italiane.

Botimi në gjuhën italiane është realizuar fal ndihmesës së Ministrisë së Punës dhe të Politikave Sociale, në bashkëpunim me Qendrën kombëtare të dokumentimit dhe të analizave për fëmijët dhe adoleshentët.

IPEC/ILO nxit prodhimin, ribotimin, përshtatjen dhe përkthimin e pjesshëm ose të plotë të këtij botimi, që të promovohet veprimtaria për të luftuar dhe për të eliminuar punën e fëmijëve. Kushdo që kryen përshtatjen apo përkthimin e këtij materiali, është i lutur të citojë burimin nga është marrë, si dhe të dërgojë një kopje të materialit në IPEC/ILO.

SCREAM - Ndal Punës së Fëmijëve.
Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias.
Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC),
Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Gjenevë, 2003.

Botimi në shqip u mundësua nga Programi Kombëtar i IPEC në Shqipëri, me fonde të Qeverisë Italiane, nëpërmjet Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, FSASH.

ISBN 978-99943-59-03-5
"Medaur"

Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe: As. prof. dr. Pranvera Kamani

Redaktimi: Sali Hamzaj

Për informacion të mëtejshëm për SCREAM, drejtohuni në:

Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC)
Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO)
4, Route des Morillons, CH-1211 Ginevra 22, Svizzera
Fax: + 41 22 799 81 81
E-Mail: scream@ilo.org
Internet: www.ilo.org/scream

Parathënie

Puna e fëmijëve shfrytëzon shtresën më të dobët dhe të ndjeshme të shoqërisë, fëmijët. Dihet se më shumë se 246 milionë fëmijë në botë, nën moshën 18 vjeç, janë të detyruar të punojnë. Pothuajse 3/4 e tyre, pra 180 milionë fëmijë, janë në rrezik për jetën. Shumicës prej tyre u mohohet e drejta për t'u arsimuar, si dhe janë viktima të dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike. Për shkak të punës, disa prej tyre pësojnë trauma që i bëjnë invalidë për gjithë jetën, të tjerë vdesin para se të arrijnë moshën e të rriturit.

Për shumë njerëz, puna e fëmijëve është e padukshme. Në disa raste, fëmijët punojnë në kushte që është e vështirë t'i shohësh (si nëpër shtëpi) apo kur janë objekt i prostituimit a në raste të tjera, kur shoqëria nuk do t'i shohë. Të sensibilizosh shoqërinë për punën e fëmijëve, do të thotë t'ia bësh të njohur këtë plagë të rëndë shoqërisë dhe ta shkundësh atë nga indiferenca.

Nëpërmjet IPEC (Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve), ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) po bëhen të gjitha përpjekjet që puna e fëmijëve t'i mbetet të shkuarës. Meqë shkaqet e kësaj dukurie janë të shumta dhe komplekse, e tillë duhet të jetë dhe përqasja ndaj saj si nëpërmjet ratifikimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare, edhe nëpëmjet zhvillimit të programeve që përfshijnë mobilizimin e grupeve të rëndësishme shoqërore.

Veçanërisht të rinjtë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sensibilizimin e komunitetit për çështje të së drejtës sociale dhe janë në gjendje të ndikojnë në proceset e ndryshimit të shoqërisë. Edhe pse fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë përbëjnë një grup të rëndësishëm të popullsisë së planetit, hapësira që u lihet për të shprehur mendimin dhe vlerësimin e tyre për funksionimin shoqërisë, është e kufizuar. Mënyra e tyre e të menduarit dhe të vepruarit mbart modele që u ka diktuar shoqëria, duke e zbehur perspektivën e vlefshme të të menduarit të tyre. Duke mbështetur të rinjtë, duke i bërë ata të përgjegjshëm, duke vlerësuar dhe duke njohur ndihmesën e tyre, shpresojmë të nxisim krijmtarinë dhe përkushtimin e tyre në të gjithë botën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Nga ky këndvështrim, IPEC-u ka ndërmarrë një nisëm të re për mobilizimin socialedukativ, "SCREAM- Ndal punës së fëmijëve". Qëllimi është të promovojë të kuptuarit e dukurisë së punës së fëmijve dhe të sensibilizojë mësuesit, të rinjtë dhe komunitetin për të vepruar për mënjanimin e plotë të kësaj plage të shoqërisë. SCREAM mbështet mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias, por, njëkohësisht, paraqet edhe gjendjen e dhimbshme të fëmijëve që punojnë dhe nevojën që ata kanë për

t'u përfaqësuar. Duke përdorur metoda të reja krijuese, programi SCREAM synon t'i informojë të rinjtë për shoqërinë ku jetojnë, t'i informojë për padrejtësitë që ndeshin, duke tërhequr vëmendjen e tyre në punën e fëmijëve në botë. Qëllimi është që t'i kthejë ata në zëdhënës të fëmijëve që punojnë. Programi synon t'i pajisë të rinjtë me njohuri, t'i bëjë të përgjegjshëm dhe t'i ndihmojë të reagojnë në mënyrën e duhur.
Zhvillimi i SCREAM mbështetet shumë në artin pamor, në artin e shkruar dhe artin dramatik. Dramatizimi është një instument veçanërisht i fuqishëm që ndikon tek të rinjtë. Teatri flet me një gjuhë universale që kapërcen kufijtë gjeografikë dhe pengesat kulturore. Madje, në rrjedhën e historisë është përdorur si mjet i kohezionit social. Pra, ky program promovon deklamimin, recitimin dhe aktrimin si mjete të cilat të rinjtë mund t'i përdorin për të zbuluar dhe për të shprehur ndjenjat e tyre, si dhe për t'i përcjellë mesazhe komunitetit. Me ndihmën e mjeteve të përshtatshme, të rinjtë mund të fitojnë besimin për të krijuar dhe për të vënë në skenë idetë dhe mendimet e tyre, në përshtatje me kushtet socialkulturore të mjedisit ku jetojnë.

Shumëkush që i është bashkëngjitur realizimit të këtij programi, dëshiron që ky të këtë një përhapje në të gjithë botën.

Në emër të tyre, si dhe në emër të miliona fëmijëve që sot shfrytëzohen, ju ftojmë të përshtatni programin SCREAM në të gjitha shtetet anëtare. Gjithashtu, ua drejtojmë autoriteteve të arsimit, shoqatave të mësuesve, organizatave të punëdhënësve, OJF-ve, shoqatave e organizatave të çfardolloji qofshin, çdo individi që punon me të rinjtë ë fushën e edukimit. Bëhet fjalë për një program që synon të përmirësohet dhe të fuqizohet gjatë përdorimit.
Pra le ta përdorim.

Alice Ouédraogo
drejtore e përpunimit të politikave
dhe veprimtarive sensibilizuese
IPEC

Falenderime

IPEC, Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve, ka filluar në vitet '90, në kuadër të nismave ndërkombëtare të ILO-s, për t'u përballur me problemin e shfrytëzimit komercial të fëmijëve. Në këtë drejtim, janë bërë hapa të shumtë përpara, por edhe pse ka patur një angazhim të madh të qeverive dhe të ndërmjetësve të tyre, puna e fëmijëve mbetet një problem shumë i madh në nivel ndërkombëtar. Mënjanimi i plotë i punës së fëmijëve do të arrihet vetëm nëse veprimtaritë e përbashkëta ndërkombëtare që synojnë reduktimin e varfërisë, do t'i kushtojnë dukurisë së punës së fëmijëve vëmendje parësore duke e futur në programet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, të organizmave të Kombeve të Bashkuara, si dhe të donatorëve bilateralë dhe multilateralë. Në këtë kuadër, roli dhe rëndësia e veprimtarisë së strukturave shtetërore përbën një element shumë të rëndësishëm për politikat e financimit në nivel ndërkombëtar. Patronati kombëtar do të përcaktojë mënyrat dhe mjetet me të cilat vëndet do të modelojnë programin e tyre në kohë (Time Bound Program), që do të përfaqësojë ndërhyrje konkrete që shprehin njëkohësisht angazhimin e tyre etik dhe legal.

IPEC vepron sot në 75 vende, por mbetet ende shumë për të bërë, veçanërisht në fushën e sensibilizimit. Veçanërisht rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për ekzistencën e punës së fëmijëve dhe mënjanimin e saj të plotë, mbetet një ndër objektivat kryesorë. Nëpërmjet SCREAM, të rinjtë do kuptojnë dhunimin e madh moral që u bëhet fëmijëve që punojnë. Të rinjtë duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në të gjitha proceset vendimmarrëse, pasi kjo ndihmon në nxitjen e potencialeve të tyre për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve në komunitetin e tyre. Përfshirja e tyre aktive shkallë-shkallë në këtë fushatë, përbën një nga objektivat kryesorë të SCREAM.

Fushata botërore e sensibilizimit dhe të të kuptuarit të dukurisë së punës së fëmijëve, e mbështur nga qeveria Italiane, që i hapi rrugën SCREAM-it, përqendrohet në tri fusha veprimi: krijimi i raporteve të rëndësishme me mjetet e komunikimit kombëtar dhe ndërkombëtar; zhvillimi i të rinjve duke promovuar dhe duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në këtë fushatë; konsolidimi i bashkëveprimit ndërmjet organizatave dhe agjensive të ndryshme. Të tria këto fusha lidhen ndërmjet tyre dhe ndihmojnë njëra-tjetrën. Në mënyrë të veçantë, secila prej tyre luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fushatës për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, por të tria së bashku përbëjnë, pa dyshim, një forcë të rëndësishme ndryshimi, pasi veprimtaria e tyre e përbashkët gjeneron ndryshime të rëndësishme në sjelljen sociale, pranon përfshirjen aktive të organizatave të punës, të organizatave të punëdhënësve, të OJF-ve, të instiucioneve akademike dhe arsimore, për të krijuar një bashkim forcash që sjellin përfundime të qëndrueshme në planin diplomatik dhe politik. Përvojat e pilotuara në disa vende të botës, kanë treguar se SCREAM-i është një katalizator i aftë të shumëfishojë energjitë në të gjitha elementet.

Mjetet e komunikimit dhe komuniteti akademik, përfshirë këtu dhe institutet e

larta të arsimit e të kërkimit, u janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së IPEC-ut për ndihmë. Për këtë i falenderojmë përzemërsisht për asistencën që na kanë ofruar, duke shpresuar në bashkëpunimin e mëtejshëm. Programi ofron, gjithashtu, hapësira të reja bashkëpunimi me sektorë dhe fakultete të tjera, siç janë: mjetet e komunikimit, institutet që merren me studime sociale, antropologjike, me zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe kualifikimin e mësuesve. Është e natyrshme që IPEC-u të përfitojë nga studimet dhe përfshirja e këtyre instancave në realizimin dhe promovimin e SCREAM-it, por, në të njëjtën kohë, edhe pedagogët dhe studentët e këtyre fakulteteve do të pasurojnë veprimtarinë e tyre, duke u përfshirë në këtë problematikë që paraqet interes të madh.

Fushata botërore pranon se mjetet e komunikimit në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar luajnë një rol të madh për sensibilizimin e shoqërisë për problemin e punës së fëmijëve. Por është shumë e rëndësishme që informacioni që jepet, të jetë i përpunuar mirë dhe të bëhet në mënyrën më të mirë të mudshme, brenda kufijve të vendit, duke përfshirë mjetet e komunikimit masiv, si: radion, televizionin dhe shtypin. Janë zhvilluar një sërë seminaresh rajonale, ku janë përfshirë gazetarë profesionistë dhe bashkëpunëtorë të shtypit, të cilat kanë ngjallur interesin e publikut në lidhje me parimet e shfrytëzimit të punës së fëmijëve dhe pasojat negative që mbart ajo.

Aksioni SCREAM dhe përgatitja e paketës së moduleve edukative është rrjedhojë e punës dhe pjesëmarrjes së shumë aktorëve. Para së gjithash, dua të shpreh mirënjohjen time ndaj qeverisë italiane, e cila me vizionin dhe bujarinë e saj bëri të mundshme realizimin e SCREAM-it, si dhe Nick Grisewood-in që hartoi dhe eksperimentoi zbatimin e moduleve, që me punën, frymëzimin dhe energjinë e tij, ka qenë vendimtar në suksesin e SCREAM-it. Një falenderim i veçantë është për Alice Ouédraogo, drejtore e përpunimit të veprimtarive dhe politikave sensibilizuese të IPEC-ut, që ka dhënë ndihmesë të çmueshme në realizimin e programit, si dhe Geir Myrstad, Zv/Drejtor në IPEC, për ndihmën dhe këshillimin që ka dhënë. Mirënjohja ime është edhe për Christina Jackson Grisewood që na ndihmoi me idetë dhe përvojën e saj, si dhe në redaktimin e bocave të moduleve. Gjithashtu, dëshiroj të falenderoj Marthe Reinette që me humorin dhe ndihmesën e saj të frytshme, ka qendruar pranë nesh në orët e gjata të punës, si dhe Laura Addatin, përpjekjet e së cilës na shërbyen shumë në fazën fillestare të SCREAM-it dhe për ndihmën e vazhdueshme që na dha në fazën përgatitore të nisjes së programit në El Salvador. Gjithashtu, dëshiroj t'i drejtoj një falenderim të ngrohtë edhe grupit të kolegëve të IPEC-ut në Gjenevë, që me entuziazëm ka mbështetur punën e SCREAM-it, veçanërsisht për Anita Amorim, Maria Arteta dhe Sule Calgar.

Botimi është bërë i mundshëm falë ndihmesës së Ministrisë së Punës dhe Ndihmës Sociale në bashkëpunim me Qendrën kombëtare të dokumentimit dhe analizave për fëmijët dhe adoleshentët.

SCREAM synon t'u japë fuqi të rinjve, prandaj është shkruar për të rinjtë dhe në bashkëpunim të ngushtë me ta. Në këtë kuptim, dëshiroj t'i shtrij më tej falenderimet e mia ndaj të rinjve dhe personave që kanë mbështetur IPEC-un në fazën e eksperimentimit në Republikën e Irlandës dhe në Nepal:

- Studentët e vitit akademik 2000-2001, drejtoritë dhe trupat akademike të kolegjeve Scariff dhe Counti Cleare në Irland;

- Anne Jones, për ndihmën e çmueshme që ka dhënë në zhvillimin e veprimtarive në Irlandë, si dhe Ray Conway për realizimin e videokasetave të SCREAM;
- Larry O'Loughlin dhe Denise Moroney, për ndihmesën e tyre të pallogaritshme në projektin e Irlandës.
- Grupin e të rinjve dhe skuadrën e CWIN (Child Workers in Nepal Concerned Center), fëmijët punëtorë në qendrat e interesit në Nepal, NDT, në Katmandu, Nepal
- Grupin e nxënësve, drejtorin, nëndrejtorin dhe trupin pedagogjik të shkollës Shuvatara në Katamandu;
- Suni Pokharel dhe Hazel Roy për punën e rëndësishme që kanë kryer gjatë realizimit të projektit në Nepal;
- Krishna Shrestha, Nepalaya dhe trupën e tij për filmimet në Nepal.

Faza e eksperimentimit në Nepal hasi vështirësi që lidheshin me situatën politike në vend. Jam borxhli ndaj Leyla Tegmo-Reddy, Aditee Maskey, Bimal Rawal, Gasper Edmonds dhe personelit të Zyrës së ILO-s në Katmandu për këmbënguljen që shfaqën në kapërcimin e vështirësive.

SCREAM ka lënë gjurmë dhe në Lindjen e Mesme, veçanërisht në Jordani. Dua të veçoj këtu grupin e studentëve të shkollës kombëtare ortodokse në Amman dhe drejtorin e saj Azmi Shahin, si dhe z. Munir Al-Hour e profesorin Ayman Massanat Dabdub për gatishmërinë që kanë treguar në realizimin e programit.

Pjesëmarrja e të rinjve ka qenë një element themelor i projektit dhe i paketës së moduleve SCREAM-it. Dëshiroj të falenderoj Valeria Morra, drejtore e departamentit të projektimit dhe prodhimit multimedial të qendrës ndërkombëtare të informacionit në ILO me seli në Torino, Itali, për punën e saj gjatë hartimit të projektit, si dhe për përfshirjen e studentëve të Institutit Evropian të Dizainit në Torino në projektimin e SCREAM. Me këtë rast, dua të falenderoj veçanërisht Irene Alasia, Melody Amerio, Marzia Boaglio e Marcello Turco që na shpjeguan shpirtin e SCREAM. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë edhe për mësuesit Janusz Kaniewski, Carsten Astheimer dhe Luana Ravera, si dhe skuadrën e Qendrës së Formimit të Torinos, ku bëjnë pjesë Enzo Fortarezza (drejtor artistik), Denise Zoccola (botuese) dhe Michele McClure (asistente).

Një falenderim të veçantë për nxënësit e orkestrës Suzuki të Torinos dhe drejtuesit të palodhur Antonio dhe Lee Mosca, që me dhuntitë e tyre muzikore kanë dhënë e japin ndihmesë për të nxitur ndërgjegjësimin për punën dhe të drejtat e fëmijëve në përgjithësi.

Një nderim të veçantë për Didier Bregnard, përpjekjet e palodhura të të cilit bënë të mundshme realizimin e katalogut të fotografive IPEC në CD-ROM, një variant i veçantë i SCREAM-it, që është pjesë e paketës edukative të programit.

Një pjesë e rëndësishme e paketës, krahas moduleve, është fryt i punës së dy mësuesve të mrekullueshëm, Michal Pasternak dhe Tim Williams. Gjatë festivalit të teatrove për punën e fëmijëve, të ideuar dhe organizuar nga këta mësues, më 1996, ISTA (Interanational Schools Theatre Association - Shoqata Ndërkombëtare e Teatrit të Shkollës), u lidh me IPEC-un, duke ndihmuar kështu

të kuptuarit, forcën dhe rolin që mund të luajë teatri në procesin e sensibilizimit.

Shumë njerëz dhe organizata kanë shpenzuar kohë, energji dhe punë vullnetare për të realizuar programin SCREAM. Vlerësoj shumë ndihmesën e të gjithëve, pasi falë punës së tyre është bërë i mundshëm realizimi i SCREAM-it.

SCREAM-i është porta, kapërcimi i së cilës, i fut të rinjtë në rrugën e të kuptuarit, të ndërgjegjësimit dhe të veprimit. Njerëzit që u zbulojnë të rinjve qenien e kësaj porte dhe i mësojnë ta hapin, jeni ju, mësuesit dhe edukatorët e të gjithë botës. Prandaj merreni këtë përgjegjësi dhe na ndihmoni në arritjen e objektivit tonë për të shpërndarë informacionin, për të çjerrë vellon e padukshme që mbështjell fëmijët që punojnë, për të shkundur shoqërinë nga indiferenca ndaj dhimbjes dhe vuajtjes së këtyre fëmijëve. Vlerësimi im i fundit u kushtohet fëmijëve që punojnë, pasi heshtja e tyre e mbushur me dhimbje, thirrja e tyre "Ndihmë!" është në zemër të SCREAM-it.

Maria Gabriella Lay
përgjegjëse e projektit
Organizata Ndërkombëtare e Punës

Falenderime për burimet

Për realizimin e moduleve të SCREAM-it, kanë shërbyer botime të ndryshme, veçanërisht, artikuj, të cilët kanë dhënë informacionin bazë për realizimin e moduleve. Gjithashtu, autori shpreh falenderimet ndaj ILO, IPEC, UNICEF, Edukimit Ndërkombëtar (IE), Departamentit të Zhvillimit të Kurrikulës në Mary Immaculate College, Limerick, Irland, Christian AID, ISTA, udhëzuesit të mësuesve dhe nxënësve dhe festivalit të tyre të teatrit, organizaur më 1996, në Gjenevë. Veçanërisht dy persona kanë ndihmuar në realizimin e moduleve: Tim Williams, pedagog dhe konsulent për dramën, i cili nëpërmjet botimit të tij të mrekullueshëm "Drama", ka ndihmuar aktivisht në realizimin e moduleve "Loja me role" dhe "Dramatizimi"; Larry O'Loughin, autor dhe pedagog ndërkombëtar irlandez, puna e të cilit është në themel të modulit "Shkrimi krijues".

Shënim për botimin në gjuhën shqipe

Modulet e këtij programi, krahas vlerave të mirëfillta për të cilën janë përgatitur, mund të përdoren me sukses edhe në punën e përditshme në shkollë tonë duke i bashkërenduar edhe me materiale të tjera të përgatitura nga Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve, si, p.sh., me manualet "Veprimtari ekstrakurikulare", botime të viteve 2004, 2006 dhe "Manual mbi punën e fëmijëve" për mësues, i përgatitur dhe i botuar po nga instituti më 2004. Me fillimin e zbatimit të planit të ri mësimor, çdo klasë nga viti I-XII ka 1-2 orë mësimi për veprimtaritë ekstrakurrikulare. Mendojmë se programi SCREAM, me të 14 modulet që e përbëjnë, është një mjet me vlerë për mësuesit e nxënësit për ta përdorur sidomos për planifikimin dhe zhvillimin e orëve të mësimit dhe për organizimin e veprimtarive edukative, argëtuese dhe sensibilizuese brenda e jashtë shkollës. Vlerë të veçantë për shkollën tonë kanë format interaktive që parashtrojnë këto module për rritjen e cilësisë së mësimit e të edukimit, rritjen e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në këtë proces dhe shndërrimin e tyre në një forcë aktive me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme dhe në përfshirjen e të gjithë aktorëve në zgjidhjen e problemeve të shkollës.
Në botimin e programit SCREAM në gjuhën shqip janë bërë përshtatje të nevojshme që japin gjendjen e punës së fëmijëve në kushtet tona.
Në modulin "Informacioni kryesor", në shtesën 4 jepet informacion shtesë për punën e fëmijëve në Shqipëri.
Në modulin "Kërkimi dhe informacioni" janë dhënë adresa të reja web-i që japin informacion për punën e fëmijëve në Shqipëri. Gjithashtu, po në këtë modul janë dhënë të gjitha botimet e bëra nga "Njësia e punës së fëmijëve" MPÇSSHB, si dhe nga Zyra IPEC në Shqipëri që do t'u shërbejnë edukatorëve dhe të rinjve si burim informacioni dhe njohjeje për problemin e punës së fëmijëve.
Në modulin "Tregu i punës", është dhënë informacion shtesë për veprimtarinë e shtetit dhe të sindikatave në kuadër të punës që kryejnë për eliminimin e punës së fëmijëve.

Hyrje

Puna e fëmijëve është shprehja më e tmerrshme e dhunimit të të drejtave të tyre. Ajo u mohon fëmijëve fëmijërinë e qetë dhe pa mundime. Ju mohon atyre të drejtën për të këputur hallkën e rrethit vicioz të varfërisë dhe dëshpërimit, në të cilin kanë lindur. Është burim i pashtershëm i dhimbjes, vuajtjes fizike dhe psikologjike. Dënon më të dobtit që nuk kanë mjete për t'u mbrojtur. Përbën një kërcënim të rëndë për të ardhmen e njerëzimit dhe të planetit tonë.

Falë IPEC-ut, Programit Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (Interanational Programme on the Elemination of Child Labour), si dhe organizatave të tjera që kanë të njëjtët objektiva, diçka është bërë për të larguar fëmijët nga puna, duke i futur në shkollë, duke i riintegruar në familjen e origjinës, duke i ndihmuar familjet të gjejnë burime të të ardhurave alternative. Por ende ka shumë rrugë për të bërë. Për të mënjanuar tërësisht punën e fëmijëve, është e nevojshme të ndryshojë sjellja e shoqërisë. Për të arritur këtë qëllim, duhet të mobilizohen dhe të edukohen njerëzit, veçanërisht të rinjtë, në mënyrë që të fitojnë besimin e duhur. Është kjo arsyeja që IPEC-u ka përkrahur zhvillimin e nismës SCREAM – *Stop Child Labour* (SCREAM – Ndal punës së fëmijëve), për t'i pajisur të rinjtë me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të realizuar një ndryshim shoqëror.

Nisma për Eliminimin e Punës së Fëmijëve, bazohet në hartimin e një seri modulesh edukative, që kanë për qëllim përfshirjen aktive të të rinjve në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Përdorimi i moduleve është i përshtatshëm në të gjitha rrethanat kulturore dhe gjeografike të arsimit formal ose jo. Modulet u drejtohen kryesisht adoleshentëve që i afrohen moshës së të rriturve, kohë kjo kur fillojnë të hyjnë në rolin e qytetarit të përgjegjshëm, sjelljet e të cilit do të kenë ndikim jo vetëm tek njerëzit që i rrethojnë, por dhe më tej.

Adoleshenca është një etapë në jetën e njeriut, në të cilën i riu ka nevojë të dijë të orientojë pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive energjitë e mëdha që ka, gjithashtu të orientojë pozitivisht gjendjen emocionale, duke përfshirtë këtu dhe zemërimin që është karakteristike për këtë etapë të jetës. IPEC-u uron që me kalimin e kohës, programi SCREAM[1] të gjejë zbatim në çdo nivel të arsimit, duke filluar që nga shkolla fillore, në arsimin e mesëm dhe në nivelin e formimit gjatë gjithë jetës.

Kjo nisëm e IPEC-ut u mundëson të rinjve të shprehen në mënyrën e duhur, sipas kulturës dhe traditës nga vijnë, nëpërmjet formave të ndryshme të artit të shkruar, viziv dhe aktrimit. Nëpërmjet këtij procesi edukativ, duke zhvilluar një nivel të mirë ndërgjegjësimi, i cili do t'u trasmetohet edhe bashkëmoshatarëve, të rinjtë do të përvetësojnë aftësitë dhe besimin për t'u përçuar prindërve, të afërmve,mësuesve, komunitetit dhe autoriteteve lokale mesazhin e tyre edhe të brezave më të rritur të shoqërisë.

Nëpërmjet arsimit dhe edukimit mund të ndryshojnë dhe të modifikohen sjelljet e shoqërisë. Pra, bëhet fjalë për një nga metodat më efektive që mobilizon sektorët më të rëndësishëm të shoqërisë, jo vetëm të rinjtë që janë të hapur ndaj ideve dhe nismave të reja. Duke ndërgjegjësuar të rinjtë për çështjet që u takojnë drejt-përdrejt, përfshirë këtu dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, edukatori mund t'i ndihmojë të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të tyre, të orientojnë energjitë në veprimtari konkrete dhe të ndajnë mendimet dhe idetë e tyre me një komunitet gjithmonë e më të gjerë. Në këtë mënyrë, të rinjtë do të luajnë një rol më aktiv në shoqëri, duke u bërë zot të veprimeve, të fateve të tyre dhe të bashkëmoshatarëve. Ata nuk do të shihen më nga shoqëria si një grup pasiv që ka nevojë për mbrojtje.

Në historinë e njerëzimit, teatri ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në pasqyrimin e zhvillimit të shoqërisë. Nëse e shohim historikisht rolin e teatrit, bindemi se ka realizuar dhe vazhdon të ndihmojë në formimin, edukimin dhe argëtimin e një grupi njerëzish. Teatri na ndihmon të ndihmojmë të tjerët. Ai shërben si një pasqyrë për gjëra

---

1. IPEC është program i veçantë i ILO-s (Organizata Ndërkombëtare e Punës), agjenci e Kombeve të Bashkuara për punën dhe drejtësinë shoqërore

që zakonisht nuk i shohim dhe që i shpëtojnë vështrimit tonë. Është një metodë e shkëlqyer mësimore për fëmijët dhe të rinjtë, pasi ndërthur argëtimin dhe spetaklin në një mjet të vetëm, i cili zhvillon besimin, kujtesën, disiplinën dhe vetëvlerësimin.

Urojmë që këto module edukative t'i ndihmojnë të rinjt të njohin më mirë mjedisin ku jetojnë, të kuptojnë si kushtëzohet jeta e tyre nga zhvillimi social, ekonomik jo vetëm në kuadrin kombëtar, por dhe rajonal dhe global. Të rinjtë duhet të të ndjehen qytetarë të botës dhe si të tillë kanë të drejtë të informohen për këtë botë, për padrejtësitë që ekzistojnë dhe për të drejtat e tyre. Ata duhet të ndërgjegjësojnë kuptimin e vërtetë të përgjegjësisë, respektit dhe gjithëpërfshirjes. Duhet të gjejnë vendin e tyre në luftën globale kundër punës së fëmijëve.

Filozofia e programit SCREAM

Zhvillimi i moduleve të programit realizohet nëpërmjet artit viziv, letrar, spetaklit, si dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit, organizimit të fushatave dhe krijimit të rrjeteve të bashkëpunimit. Gjithashtu, programi synon të promovojë një proces edukimi dhe integrimi të komunitetit dhe t'i vërë të rinjtë në kushte të tilla që ata të luajnë rolin e agjentëve që mobilizohen për të nisur ndryshime shoqërore.

Pa dyshim, bëhet fjalë për një program ambicioz, por pa një ambicie të tillë nuk mund të ndalet rritja e numrit të fëmijëve që punojnë në botë. Jo rrallë fëmijët punojnë në kushte të tmerrshme dhe të rrezikshme. Më 2002, ILO ka publikuar një raport botëror "E ardhmja pa punën e fëmijëve", sipas të cilit, në bazë të treguesve të një studimi, në botë ka 245,5 milionë fëmijë, nën moshën 18 vjeç, që punojnë. Nga këta, rreth 180 milionë fëmijë punojnë në kushtet më të këqija të mundshme. Për të ndikuar në përmirësimin e situatës, duhet një mobilizim i përgjithshëm, një përfshirje masive e njerëzve dhe, para së gjithash, e të rinjve. Por, fatkeqësisht, të rinjtë nuk janë trajtuar si një forcë e rëndësishme në realizimin e nismave ndërkombëtare për mënjanimin e plotë të punës

së fëmijëve. Ka ardhur koha t'i përfshijmë aktivisht ata në këtë nismë.

Për të çrrënjosur punën e fëmijëve, nuk duhet punuar vetëm në ato vende ku sundon kjo plagë e shoqërisë. Është po aq e rëndësishme të luftosh edhe në ato vende, të cilat mendojnë se puna e fëmijëve nuk ekziston. Në të vërtetë, në shumë vende, ka fëmijë që punojnë dhe për këtë duhet të ndërgjegjësohen të rinj dhe të vjetër. Nëse mbyllim sytë ndaj realiteteve të dhimbshme që na rrethojnë, do t'i bëjmë bisht përgjegjësive që kemi, dhe me ndërgjegje do të dënojmë me varfëri dhe me punë poshtëruese dhe të rëndë të ardhmen e një numri të madh fëmijësh. Apo, edhe më keq, nëse nuk u hapim sytë fëmijëve tanë për atë çfarë ndodh në botë, i lëmë ata në padituri dhe natyrshëm i bëjmë indeferentë ndaj realitetit. Kjo gjë nuk është e ndershme dhe e drejtë.

Është e udhës që pjesa më e madhe e përpjekjeve dhe e energjive tona të drejtohen në ato vende ku mbizotëron puna e fëmijëve, veçanërisht ku fëmijët shfrytëzohen me format më të këqija të punës. Qeveritë, sipërmarrësit, të gjitha organizatat kanë nevojë për mbështetje për të larguar fëmijët nga tregu i punës, për t'i risjellë pranë familjeve të tyre dhe për t'u ofruar arsim dhe një të ardhme që mund të përballohet nga familja. Tashmë është bërë e njohur nevoja në rritje e një mbështetjeje të fuqishme të strategjive lokale. Do të duhet kohë dhe një angazhim ndërkombëtar më i madh, ku, pa dyshim, ILO dhe IPEC synojnë për më shumë.

Fusha të tjera ku IPEC-u do të shtrijë veprimtarinë e tij, janë arsimi dhe veprimtaritë sensibilizuese. Veçanërisht në strategjitë kombëtare të vendeve për reduktimin e varfërisë, si dhe të programeve të zhvillimit, arsimi, në radhë të parë arsimi fillor i detyruar, duhet të jetë një ndër objektivat parësorë. Në këtë kuadër bëhet botimi i këtij programi edukativ. Nëse dëshirojmë që puna jonë të ketë rezultate dhe jetëgjatësi, duhet të përfshijmë aktivisht të rinjtë. Nuk është një koncept i vështirë. Thjesht do të thotë të mundësosh që arsimimi dhe ndërgjegjësimi të jenë një komponent i rëndësishëm në strategjinë tonë globale.

Një karakteristikë themelore e nismës së re të IPEC-ut është gjithëpërfshirja, pra përfshrija e të gjithëve që mund

të luajnë një rol në mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Ky proces bazohet në veprimtaritë dhe në strukturën tripalëshe të ILO-s: punëtorët, sipërmarrësit dhe qeveritë, të cilët bashkërisht japin ndihmesë për të përcaktuar standardet e vendeve të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në të gjithë botën. Modeli i IPEC-ut promovon përfshirjen, në të gjitha aspektet e veprimtarisë edukative, të të gjitha palëve: qeveritë dhe autoritetet lokale, sindikatat, punëdhënësit, OJF-të, mësuesit dhe edukatorët, familjet dhe prindërit. IPEC-u thekson nevojën për të përfshirë fëmijët që punojnë në programin SCREAM. Këta të fundit janë ata që do të përfitojnë më shumë dhe integrimi i tyre në program do të shënojë suksesin e SCREAM-it.

Edukimi ndërmjet të barabartëve, pra të rinj që u mësojnë të rinjve të tjerë, ky është një tjetër objektiv i moduleve. Mendojmë se është metoda më e mirë me anën e së cilës mund t'i takojmë të rinjtë dhe t'i bindim se puna e fëmijëve është shkatërruese, çnjerëzore dhe që duhet të çrrënjoset. P.sh., gjatë fazës së eksperimentimit në Irlandë, të rinjtë e përfshirë në programin SCREAM realizuan një nga modulet (kolazhin) me nxënësit e një shkolle fillore. Falë kësaj metode, u bë e mundshme t'u shjegoheshin fëmijëve arsyet që shkaktojnë punën e bashkëmoshatarëve të tyre, t'u shpjegohej se është e rëndësishme që shoqëria të jetë e përgjegjshme dhe të luftojë për ta zhdukur atë dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të tyre. Në këtë mënyrë mund të përfshihen me mijëra e mijëra njerëz në fushatat për të luftuar konkretisht kundër punës së fëmijëve në brezat që vijnë.

Paketa e mjeteve didaktike SCREAM

Botimi i paketës së parë të mjeteve didaktike SCREAM, përmban 14 module dhe këtë udhëzues. Kompleti përmban edhe CD-rom, të katalogut të fotografive të IPEC-ut, që paraqet fëmijë që shfrytëzohen në forma të ndryshme pune. Këto fotografi mund të përdoren gjatë realizimit të veprimtarive të ndryshme të programit SCREAM, p.sh., në modulin "Figura". Disa nga fotografitë më përfaqësuese janë përfshirë në paketën e mjeteve didaktike.

Tërheqim vëmendjen se përdorimi i fotografive të CD-ROM, të katalogut të IPEC-ut, duhet të përdoret vetëm nga edukatorët që janë përfshirë në realizimin e programit SCREAM. ILO, që ka të drejtën e autorit dhe copyright, nuk autorizon përdorimin e tyre për qëllime të tjera nga ato të programit SCREAM. Nëse dëshironi të përdorni fotografitë jashtë programit, jeni të lutur t'i drejtoheni arkivës së fotografisë së ILO-s, që të merrni udhëzimet e duhura për kushtet e riprodhimit të tyre. Adresën do të gjeni në katalogun që u drejtohet adresave të lidhjeve.

IPEC-u, gjithashtu, do të vërë në dispozicion një video pedagogjike ku paraqiten dy momente të rëndësishme të realizuara në Irland dhe Nepal.

Lista fillestare përmban modulet e mëposhtme:

- **Informacioni kryesor**. Përmban të dhënat kryesore për punën e fëmijëve. Paraqet çështjen e punës së fëmijëve në mënyrë të kuptueshme nga të rinjtë, duke dhënë shifra, tregues statistikorë dhe informacionin kryesor.

- **Kolazhi.** Paraqet dy kolazhe, njërin për një temë klasike të marketingut dhe tjetrin për punën e fëmijëve. Nxit të shprehurit artistik viziv dhe pasqyron vëmendjen e pamjaftueshme që shtypi ka për problemin e punës së fëmijëve.

- **Kërkimi dhe informacioni.** Shërben për të zbuluar dhe për të gjetur një informacion sa më të gjerë për punën e fëmijëve, përfshirë këtu dhe konventat ndërkombëtare, për t'u thelluar në këtë problem.

- **Intervista dhe sondazhe.** Shërben për të zhvilluar një intervistë apo sondazh në mjedise që interesohen për punën e fëmijëve. Mbështet aspektin edukativ të komunitetit dhe nxit interesin. Paraqet teknikat e intervistës dhe nxit veprimtarinë kërkimore për të nxjerrë në dukje se ç'bëjnë të tjerët për punën fëmijëve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë.

- **Figura.** Shërben për të krijuar profilin e një fëmije që punon duke u nisur nga figura të ndryshme. Duke parqitur këtë figurë nxiten të pranishmit të përfshihen në këtë veprimtari emcionalisht dhe në mënyrë të ndërgjegjshme në trajtimin e këtij problemi. Për të komunikuar ndjenjën e përgjegjësisë ndaj fëmijëve që paraqiten në fotografitë, bëhet pyetja si mund të bëhemi nismëtarë të disa ndryshimeve sociale.

- **Loja me role.** Shërben për t'u futur në rolin e fëmijës që punon dhe të personave që kanë lidhje me të (prindërit, punëdhënësit, autoritetet). Përdoren dramatizimet me qëllim edukativ. Përdoret dramatizimi për të mposhtur ndrojtjen dhe për të ndihmuar të rinjtë të kuptojnë se ç'do të thotë të jesh një fëmijë që punon.

- **Konkursi artistik.** Shërben për të marrë pjesë apo për të organizuar një konkurs për punën e fëmijëve. Nxit shprehjen artistike dhe promovon procesin edukativ të sensibilizimit të komunitetit.

- **Shkrimi krijues.** Shkruhet një histori për një temë që do të zhvillohet. Shkruhet një histori për punën e fëmijëve me të njëjtën teknikë. Përmirëson aftësitë letrare dhe komunikuese. Ofron një mjet për të shprehur ndjenjat më të fshehta në lidhje me punën e fëmijëve. Është një mbështetje e vlefshme për të zhvilluar modulet e tjera, si, p.sh., dramatizimin, ku parashikohet shkrimi i një skenari.

- **Debati.** Shërben për të studiuar, për të përgatitur dhe për të mbajtur një debat publik për punën e fëmijëve. Për këtë, mbështetemi edhe në përvojën e krijuar gjatë realizimit të moduleve të tjera, veçanërisht në modulin e studimit, të informacionit, shkrimit krijues, lojës me role. Zhvillon aftësitë e komunikimit dhe të diskutimit. Ky modul mundëson sensibilizimin e komunitetit.

- **Mjetet e komunikimit** (dy module). Shërben për t'u përballur me botën e mjeteve të komunikimit, për të hyrë në marrëdhënie me mjetet e komunikimit, për të ngjallur vëmendjen e publikut për punën e fëmijëve, për të mësuar të shkruajnë një njoftim shtypi dhe për të siguruar botimin e tij, për të përgatitur dhe për të realizuar një intervistë radiofonike ose televizive. Rrit forcën integruese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

- **Dramatizimi.** Ky modul ka si objektiv kryesor të nxisë interesin dhe përfshirjen e komunitetit, jashtë projektit, në çështjen e punës së fëmijëve. Përforcohet roli i të rinjve si nismëtarë të ndryshimeve sociale.

- **Tregu i punës.** Synon të paraqesë mekanizmat e botës së punës. Nënvizon dhe promovon ndikimin që ka tripalshja[2] në zhvillimin social. Diskutohen rolet që kanë sektorë të ndryshëm të shoqërisë dhe mënyra si ato veprojnë në të mirë të shoqërisë.

- **Integrimi i komunitetit.** Ky modul përqendrohet në objektivin kryesor që synon të nxisë interesimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit, jashtë projektit, për punën e fëmijëve. Përforcon rolin e të rinjve si protagonistë dhe nismëtarë të ndryshimeve sociale.

Me kohë, do të realizohen modele të tjera. P.sh., sporti dhe muzika janë dy mjete të rëndësishme që nxisin interesimin dhe krijmtarinë e fëmijëve, prandaj jemi duke studiuar përgatitjen e moduleve për këto veprimtari. Muzika, ashtu si dhe teatri, kapërcen kufijtë dhe përforcon identitetin kulturor të njerëzve, siç e kemi vënë re edhe në veprimtaritë e tjera të zhvilluara në kuadër të SCREAM-it. Muzika dhe këngët mund të përfshihen në mënyra të ndryshme në veprimtaritë e SCREAM-it, veçanërisht në modulet e dramatizimit dhe të integrimit të komunitetit.

Krahas hartimit të moduleve të reja, mbi bazën e përvojës së fituar mund të zhvillohen më tej modulet ekzistuese. Modulet e reja do të jepen në internet, në faqen e IPEC-ut ose mund të sigurohen duke iu drejtuar atij, në adresën që jepet në fund të këtij udhëzuesi. Ju rekomandojmë të kontrolloni herë pas herë faqen e internetit

2. Termi tripalësh i referohet strukturës së ILO-s, ku përfshihen tre përfaqësues socialë: qeveria, punëdhënësit ,sindikata.

të IPEC-ut që të njiheni me përditësimet që bëhen në programin SCREAM, si dhe për t'u njohur me çështje të tjera që lidhen me punën e IPEC-ut.

Procesi i prodhimit të moduleve i është nënshtruar rishikimeve të vazhdueshme. Kjo na ka ndihmuar për t'i përsosur veprimtaritë, duke i bërë praktike dhe lehtësisht të përdorshme. Tashmë mund të themi se përdorimi me rregull i moduleve jo vetëm që përbën një instrument pedagogjik shumë të mirë, por, gjithashtu, na ka ndihmuar të identifikojmë ide të reja për module të tjera. Faza e eksperimentimit të moduleve u shfrytëzua edhe për prodhimin e një video didaktike për t'i dhënë një mbështetje didaktike edukatorit apo grupeve të ndryshme që duan t'i përdorin ato. Videoja jep një vështrim të përgjithshëm të realizimit të moduleve, të mënyrës si duhet të përdoren, të përfundimeve të mundshme dhe formave të ndryshme për përfshirjen e komunitetit.

Ndërtimi i moduleve është i thjeshtë. Në disa realitete, kombëtare dhe lokale, disa prej tyre mund të duken të vështira për t'u realizuar. Për të kapërcyer këto vështirësi, modulet janë konceptuar në mënyrë të tillë që janë lehtësisht të përshtatshme. Nëse nuk keni mjete për të realizuar një modul, kaloni në modulin tjetër, por mos harroni se mund të përshtatni materialin në përputhje me kushtet tuaja. Mënyra si përshtatet, varet nga edukatori. Plani që ju parashtrohet për realizimin e moduleve, ju krijon lehtësi në lidhje me realizimin e tyre në shërbim të kohës, radhës, ndërthurjeve të mundshme, duke marrë parasysh situata të ndryshme që mund të shfaqen.

Paketa SCREAM ofron një program edukimi global që mund të jetë i shkurtër apo i gjatë, në shërbim të kohës që keni në dispozicion. Mund të realizoni një modul me një objektiv specifik që lidhet, p.sh., me krijimin dhe dramatizimin e një pjese. Mund të zhvillohet në kushte të arsimit formal për të drejtat e fëmijëve. Mund të realizoni vetëm një modul ose, nëse keni mundësi, dy, tri, pse jo dhe të gjitha modulet. Modulet janë fleksibële. Për të patur një ndikim dhe frytshmëri më të madhe, ju këshillojmë t'i realizoni sipas një radhe të caktuar, duke filluar me informacionin kryesor, për të përfunduar me shprehjen artistike dhe organizimin e fushatave dhe të rrjeteve të bashkëpunëtorëve.

Një element shumë i rëndësishëm është realizimi i të gjithë programit, duke nisur nga veprimtaritë sensibilizuese, duke krijuar një përfshirje të fortë emocionale, duke krijuar, gjithashtu, dëshirën e fortë për të bërë ndryshime dhe për të kaluar më pas në veprim. Ju këshillojmë të lexoni me vëmendje të gjitha modulet para se të filloni të zbatoni programin, që të planifikoni me kujdes metodat dhe radhën e zhvillimit të tyre, sipas nevojave që keni.

Mendojmë që seria e moduleve që ju paraqesim, do të ndihmojë zhvillimin e fushatave sensibilizuese për punën e fëmijëve. Urojmë që me kohë numri i moduleve të rritet dhe cilësia e tyre të përmirësohet dhe të përditësohet falë bashkëpunimit më mësuesit dhe edukatorët që do t'i përdorin, duke na dhënë përshtypjet dhe përvojën e tyre.

Si funksionojnë modulet

Çdo modul fillon me një përmbledhje të përmbajtjes që jepet nëpërmjet një **objektivi** dhe një **rezultati** të dukshëm, si dhe **kohën e realizimit** që këshillohet. Koha për realizimin e modulit jepet e përafërt, pasi gjatë zhvillimit të modulit edhe mund të ndryshojë. Një "sesion didaktik" është rreth 40 minuta dhe bazohet në orën mësimore të shumë shkollave në botë. "Një sesion didaktik dopio" është 80 minuta. Ndonjëherë është e vështirë të trajtosh një temë brenda 40 minutave, kur njëkohësisht nuk do të ishte e këshillueshme të ndërpritej veprimtaria në mes. Kjo është arsyeja që në disa raste ju këshillojmë që të verifikoni nëse keni në dispozicion 80 minuta pa ndërprerje. Nëse në kushtet e arsimit formal kjo nuk është e mundshme, mund t'i përshtasni sipas nevojave që keni.

Nëse sasia e kohës që keni në dispozicion, përbën një problem, mos ndërprisni asnjeri, por zhvilloni veprimtarinë normalisht deri në fund të kohës që keni, duke iu rikthyer çështjes radhën tjetër. Ndërprerja e paraqitjes së produktit që të rinjtë kanë përgatitur me kujdes, mund të rrezikojë dinamikën e grupit që tashmë keni ndërtuar. Mund të

kompromentoni sigurinë dhe motivimin, pra bëni pikërishtë të kundërtën e asaj që përpiqeni të realizoni. Gjithsesi, modulet janë hartuar në mënyrë të tillë që nuk kushtëzohen nga programimi strikt i veprimtarisë. Mos u shqetësoni nëse nuk e përfundoni modulin në kohën e parashikuar. Nëse ju mungon koha, jepini grupit një mundësi tjetër kur mund të paraqesë punën.

Kapitulli i përgatitjes jep udhëzime se çfarë duhet bërë para se të fillojë veprimtaria. Këtu përfshihet procesi kërkimor për të gjetur informacionin kryesor, kërkimi i materialeve dhe ballafaqimi i parë me problemin. Gjithmonë, nëse është e mundshme, përfshini të rinjtë në këtë veprimtari përgatitore që mos t'u jepet gjithçka e gatshme, por të ndihen pjesëmarrës në fazën e përgatitjes. Kjo do të forcojë besimin e tyre dhe ndjenjën se janë pjesë e projektit.

Për secilin modul është paraqitur një listë me mjetet që nevojiten, edhe pse jo të gjitha janë të domosdoshme. Të domosdoshëm me të vërtetë janë vetëm të rinjtë. Të gjitha materialet e tjera mund të përshtaten, të zëvendësohen apo dhe të lihen fare, pra të mos përdoren.

Në secilin modul ka një pjesë ku flitet për ndihmën e jashtme. Është e natyrshme që nuk mund të keni njohuri për të gjitha metodat e përdorura në module. Nëse siguroni ndihmën e një specialisti në realizimin e disa moduleve, si, p.sh., të shkrimit krijues, të dramatizimit etj., kjo do të ishte një mundësi që duhet shfrytëzuar. Nga ana tjetër, përfshirja e pjesëtarëve të komunitetit do të realizonte objektivat e programit që janë: përfshirja e anëtarëve të tjerë të komunitetit dhe sensibilizimi i komunitetit që do ta shtrinte më tej ndikimin e programit. Për realizimin e modulit, ndihma e jashtme dhe lista e mjeteve, nuk janë të domosdoshmëri. Për të patur përfundime të mira, duhet të ndiqni udhëzimet e dhëna në modul.

Pjesa më e madhe e modulit përbëhet nga përshkrimi i **veprimtarive të veçanta**, **i metodologjisë së zhvillimit** dhe **të manaxhimit të grupit**. Përdoruesit ndihmohen për realizimin e çështjeve të ndryshme praktike që janë rrjedhojë e zhvillimit të veprimtarive. Pasi u jepet zgjidhje këtyre aspekteve, mund të vazhdoni me zhvillimin e veprimtarive që po ashtu janë shpjeguar hollësisht me këshilla e udhëzime teorike dhe praktike. Për përdoruesin

ka **shënime** që synojnë të sqarojnë ato çështje që mendohet se janë shumë të rëndësishme.

Në vijim, në pjesën **"Vlerësimi dhe vazhdimi"**, modulet marrin parasysh përfundimet që mund të priten nga realizimi i veprimtarisë dhe, më pas, mënyrën si këto mund të diskutohen nga mësuesi dhe grupi gjatë analizës. Gjithashtu, kështillohet mënyra si mësuesi mund të vazhdojë duke parashikuar realizimin e moduleve të tjera me veprimtari që kanë lidhje ndërmjet tyre.

Struktura e modulit

Titulli i modulit. Jepet përkufizimi i përpiktë i modulit, objektivat, rezultatete, koha e përafërt e realizimit dhe numri i seancave didaktike që janë të nevojshme për zhvillimin.

Motivimi. Përshkruan qëllimin e modulit, si integrohet moduli në procesin e përgjithshëm, çfarë përparësish u ofron të rinjve dhe projektit në tërësi.

Përgatitja. Ndihmon mësuesin të përgatitet për kohën e zhvillimit të sesioneve në klasë. Po në këtë kapitull janë shënimet që lidhen më shfrytëzimin e ndihmës së jashtme, takimet e para etj. Në këtë kapitull jepet edhe lista e materialeve që duhen përdorur.

Zhvillimi i modulit. Është seanca didaktike hyrëse që jep informacionin bazë, paraqet vizitorët e mundshëm etj. Po në këtë kapitull, në disa paragrafë parashikohet mënyra e organizimit të grupit dhe përgatitja e tij.

Veprimtaria. Secila veprimtari përshkruhet në detaje pikë për pikë.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar. Kjo listë do t'u shërbejë për të arritur sa më mirë objektivat e modulit dhe njëkohësisht për të mënjanuar disa momente.

Diskutimi përfundimtar. Një kohë e veçantë i lihet diskutimit dhe rrahjes së mendimeve që mësuesi të bëjë përmbledhjen e asaj që është arritur dhe pjesëtarët e grupit të shprehin lirshëm atë ç'kanë bërë dhe të shfaqin emocionet e tyre.

Vlerësimi dhe vazhdimi. Bazohet në treguesit që do t'ju mundësojnë vlerësimin e përfundimeve të arritura nga grupi, sukseset dhe dështimet, atë ç'kanë mësuar, ç'mund të bëhet për të vazhduar veprimtarinë dhe me cilat module duhet të vazhdohet.

Burimi i suksesit

Para se të zgjidhni rrugën që do të ndiqni, mendoni rreth asaj që ju ka shtyrë të lexoni udhëzuesin deri në këtë çast; ç'ju ka shtyrë të vlerësoni mundësinë e përdorimit të tij; mendoni se në ç'kushte punoni; cilat janë motivet dhe ç'detyrime ndjeni ju për t'u përfshirë në zbutjen e punës së fëmijëve; cila është përfshirja juaj, ç'angazhime keni ju ndaj grupit me të cilin punoni etj.

Dy janë elementet më të rëndësishme që sigurojnë suksesin e realizimit të këtij programi: pjesëmarrja dhe respekti. Pjesëmarrja juaj për realizimin me sukses të moduleve, për të marrë pjesë në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së punës së fëmijëve, për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të grupit të fëmijëve më të cilët punoni, dhe, ajo që është më e rëndësishmja, për të krijuar të njëjtin motivim dhe angazhim edhe të grupi më të cilin punoni.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm për suksesin është respekti reciprok. Në fazën e eksperimentimit, gjatë vlerësimit të bërë në një shkollë, fëmijët veçonin dhe vlerësonin si shumë të rëndësishëm faktin se gjatë zhvillimit të programit ata ishin ftuar të shprehnin mendimet e tyre, të cilat vlerësoheshin dhe pranoheshin nga drejtuesit. Ata kishin kuptuar se ajo ç'thoshin, ishte e rëndësishme, që ndërhyrjet dhe komentete e tyre dëgjoheshin. Pikënisje e realizimit të moduleve është roli që duhet të luajnë të rinjtë në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Roli i tyre qëndron, para së gjithash, të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe rolin e të rinjve si katalizatorë të ndryshimit brenda shoqërisë. E pra, nëse besojmë se të rinjtë janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e fushatës (në IPEC të gjithë besojnë në këtë), duhet t'i respektojmë që të rinjtë të marrin përgjegjësitë e tyre.

Këto module u japin të rinjve shumë më tepër sesa përcjellja e informacionit dhe njohurive. Ato i ndihmojnë të rinjtë të rriten dhe të kuptojnë rolin e tyre shoqëror. Në disa vende, të rinjtë mund të mos kenë besim në veten e tyre dhe atyre u mungon vetëvlerësimi, veçanërisht në moshën e adoleshencës. Një pjesë e rolit të moduleve i kushtohen nxitjes së këtyre dy anëve që janë themelore në zhvillimin e tyre. Të rinjtë do të udhëheqin këtë fushatë nëpërmjet punës kërkimore, organizimit të fushatës, shfaqjeve teatrore, krijimeve artistike, nëpërmjet mesazheve që do t'i përcjellin komunitetit në kuptimin më të gjerë të fjalës. Në këtë proces ata do të bëhen edukatorë të bashkëmoshatarëve dhe të pjesës tjetër të komunitetit. Ata janë agjentë të ndryshimit social.

Kujt i drejtohen modulet

Programi i SCREAM i drejtohet grupit të të rinjve që realizon programin edukativ. Me kujdes gjykojini të rinjtë që janë përfshirë në këtë program edukativ. Është e natyrshme që grupi i tyre do të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme. Në varësi të mjedisit ku do të punoni, disa nga të rinjtë e grupit mund të jenë edhe ata vetë fëmijë që punojnë. Përgjigjjuni vetë pyetjeve që ju lindin, ndoshta do t'ju lindin pyetje të tjera, ju do të jeni forca lëvizëse e procesit. Do të dëshironim t'ju jepnim një listë me të gjitha pyetjet, por kjo nuk është e thjeshtë. Disa prej tyre mund të mos jenë shumë të rëndësishme për mjedisin tuaj. Mos u shqetësoni, veçoni pyetjet që mund të jenë intersante për kushtet tuaja, dhe përpunoni të tjera, nëse është e nevojshme. Duhet të njihni mirë grupin me të cilin do të punoni, duhet të komunikoni, t'i kuptoni dhe të fitoni besimin dhe respektin e të gjithë anëtarëve të tij. Vetëm kështu realizimi i moduleve do të jetë më i mirë dhe i natyrshëm. Ja disa pyetje:

- Kush janë? Si quhen?
- Sa djem dhe vajza bëjnë pjesë në grup?
- Sa vjeç janë?
- I njihni mirë të gjithë?

- Ç'prejardhje kanë? Në ç'mjedis jetojnë, p.sh., cila është gjendja social-ekonomike?
- Çfarë shkolle kanë kryer? A e ndjekin shkollën? Janë analfabetë apo kanë disa vite shkollimi?
- Cilat janë kushtet e zhvillimit fizik dhe psikik? Si ju duken: komunikues, të ndrojtur, dyshues, të frikësuar, të kënaqur, të trishtuar, të keqtrajtuar, të paedukuar, nuk janë bashkëpunues etj.?
- Nëse dini se ndonjë prej pjesëtarëve të grupit është i shfrytëzuar ose ka pësuar dhunë seksuale? Nëse përgjigjja është po, këta fëmijë a kanë nevoja të veçanta? A trajtohen nga një psikiatër, psikolog ose mjek? A keni folur me prindërit, të afërmit apo mjekët e tyre? Mendoni se ndonjë prej moduleve mund t'i traumatizojë apo t'i trondisë? Si do ta zgjidhni këtë problem?
- A ka ndërmjet tyre ndonjë fëmijë me nevoja të veçanta fizike, psikike. Si mendoni të përballeni me këtë problem? Fëmijët me probleme të veçanta kanë nevoja dhe kërkesa të veçanta, a jeni në gjendje t'ua plotësoni?
- Si e vlerësoni interesin e të rinjve për problemet sociale? Shprehin një farë interesi apo vlerësoni se janë të painteresuar ose indiferentë?
- Si i vlerëson marrëdhëniet e tyre në grup? A ka moskuptime ndërmjet të rinjve? Mendoni se këto raporte mund të bëhen konfliktuale dhe problematike për grupin dhe mund të kërkojnë një vëmendje më të madhe?
- A ka përvoja pune ndonjëri prej tyre ose ka qenë " një fëmijë që ka punuar"? A kanë pasur mundësi të shohin nga afër fëmijët që punojnë? A ka ndonjë prej tyre që punon me kohë të plotë ose të pjesshme?

Në module të ndryshme trajtohen edhe probleme të abuzimit seksual të fëmijëve. Grupi do të kuptojë se fëmijët që punojnë, janë ata që kanë mundësi të abuzohen seksualisht dhe që shfrytëzimi i tyre seksual është një nga format më të këqija dhe më të dëmshme të punës së fëmijëve. Do të zbuloni se ndaj kësaj forme pune, të rinjtë janë shumë të ndjeshëm. Ata do të shokohen dhe do të shprehin një inat dhe dhimbje të thellë. Në këto raste, diskutimi i problemit nuk duhet të mënjanohet ose të fshihet vetëm për faktin që shkakton emocione të forta.

Mund të shkaktojë buzëqeshje apo ilaritet në grup, por diheni se këto janë mekanizmat klasikë të mbrojtjes që shfaqin fëmijët apo të rinjtë kur bëhet fjalë për një çështje të vështirë dhe që është për ta e sikletshme. Ndoshta nuk është e nevojshme të trajtosh këtë çështje në mënyrë shumë të ndjeshme, veçanërisht në kushtet e një shoqërie të mbyllur që nuk flet hapur për këto probleme ose kur e dini se në grupin tuaj mund të ketë fëmijë që kanë qenë apo janë viktima të dhunës seksuale.

Disa nga ushtrimet e moduleve që kanë të bëjnë me dramatizimin, shkrimin krijues, vizatimin etj., mund të japin rezultate më pozitive dhe mund t'i ndihmojnë më mirë të rinjtë të manaxhojnë traumat e tyre të kaluara apo të tashme. Por, në të gjitha rastet, për ta është një ndihmë të mësojnë se ajo që kanë pësuar, është plotësisht e dënueshme dhe e gabuar, se nuk duhet t'i nënshtrohen kësaj dhune dhe nuk duhet të lejojnë që të tjerë të kenë fatin e tyre, aq më tepër fëmijët që punojnë. Konventat dhe ligjet ndërkombëtare e ndalojnë dhunën seksuale, por jo rrallë janë vetë shoqëritë që mbyllin sytë para këtij krimi. Keqtrajtimi seksual ndodh pas dyerve të mbyllura, në disa raste në shtëpitë e fëmijëve. Duhet të ndryshojë sjellja që të këputen vargonjtë e rrethit vicioz të keqtrajtimit seksual. Të rinjtë duhet ta dinë se ligji i mbron.

Duhet të jeni të vëmendshëm ndaj të gjitha reagimeve të grupit kur diskutohet për keqtrajtimin seksual. Nëse ndonjë prej fëmijëve duket veçanërisht i prekur dhe i shqetësuar, ndoshta ka vend për të kërkuar ndihmën e një profesionisti. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohen dhe të mbahen lidhje me shërbimet përkatëse. Shqetësimi juaj kryesor duhet të jetë mirëqenia e grupit.

Ju duhet të keni një motivim të fuqishëm dhe një këmbëngulje të madhe për të analizuar gjendjen psikike të grupit, për të fituar besimin dhe respektin e tyre, të cilat ndihmojnë për zhvillimin e moduleve dhe arritjen e përfundimeve të pritshme. Të rinjtë kanë energji dhe forcë të madhe për të ndihmuar fuqishëm në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, por është dhe rreziku që të shndërrohen në armiq të betuar të kësaj fushate. Ky është një moment shumë delikat në jetën e tyre. Ata janë të mbushur me emocione që jo rrallë janë konfliktuale dhe vetë ata janë të pazotë për t'i përballuar. Roli që luajnë bashkëmoshatarët, është shumë i rëndësishë

dhe nuk duhet të nënvlerësohet, por, përkundrazi, duhet të shfrytëzohet në të mirë të punës suaj.

Gjatë realizimit të moduleve duhet t'i trasmetoni grupit këmbëngulje, motivim, energji, duhet të zgjoni te secili anëtar i tij ndjenja dhe emocione të forta dhe të luftoni pasivitetin. Bëni që vetë grupi të lëvizë, të përfshihet. Trasmetojini besim duke përdorur gjuhën e shenjave. Drejtoni energjitë e secilit në realizimin e objektivave që parashikojnë modulet. Bëni të mundur të ndjehen se puna është e tyre. Kur ta ndjejnë se projekti u përket dhe duhet ta zhvillojnë vetë, të jeni të bindur se atëhere keni fituar.

Dinamika e manaxhimit të grupit

Pjesa më e madhe e suksesit të realizimit të moduleve varet nga dinamika e procesit dhe manaxhimi i grupit. Është e rëndësishme të përqendroheni mirë para dhe pas zhvillimit të ushtrimit. Nëse nuk ka unitet brenda grupit, nëse pjesëtarët e gripit nuk ndjehen mirë në veprimtaritë që bëjnë së bashku, puna do të jetë më e vështirë.

Kushtojini vëmendje të madhe ritmit të punës së grupit. Përpiquni të njihni dhe të kuptoni mirë individët që e përbëjnë, marrëdhëniet që kanë ndërmjet tyre, si dhe nivelin e tyre. Objektivi i veprimtarive është të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithëve dhe, nëse grupi është i përbërë nga persona që kanë vështirësi të merren vesh mes tyre, kjo do të kompromentojë pjesëmarrjen në veprimtari. Nëse nuk arrini të kuptoni tensionet që ka në grup, kërkoni ndihmë nga një pjesëtar i grupit, ndonjëri që e njihni mirë, i besoni dhe i vlerësoni mendimin.

Është e këshillueshme të mos i ndani grupet sipas gjinisë. Rezultatet e moduleve mund të mos jenë pozitive, nëse do t'i gruponi djemtë dhe vajzat më vete, veçanërisht në modulet e lojës me role, të dramatizimit, shkrimit krijues. Në të gjitha veprimtaritë e programit, duhet të siguroni ekuilibrin e duhur ndërmjet meshkujve dhe femrave. Duhet të jeni të sigurtë që fëmijët të kuptojnë konceptin e barazisë dhe të respektit mes burrave dhe grave, vajzave dhe djemve.

Kjo është një periudhë tranzicioni në jetën e vajzave dhe të djemve të grupit, veçanërisht për adoleshentët në raport me seksin tjetër. Që në fëmijërinë e hershme fëmijët marrin mesazhe dhe edukohen për rolin dhe pozicionin e djemve dhe të vajzave, burrave dhe grave në shoqëri, të cilat kushtëzojnë sjelljet dhe veprimet e tyre. Në zhvillimin e shoqërisë dhe në strukturat e saj, kultura, traditat dhe sjelljet kanë ndikim të madh.

Është e rëndësishme të dëgjoni nga vetë vajzat dhe djemtë për dallimet që vërehen mes tyre kur bëhet fjalë për t'i pranuar në punë apo dhe në shkollë. Nxitja e diskutimeve u jep mundësi të rinjve të mbajnë qëndrim dhe të gjykojnë sjelljet dhe veprimtaritë e tyre, gjë që është hapi i parë drejt çdo lloji levizjeje dhe mobilizimi social. Para se ata të marrin përsipër rolin e agjentëve të ndryshimit socialë, duhet të dinë se ç'duhet të ndryshojnë dhe si ndjehen përballë çështjeve që përbëjnë sfidë për shoqërinë tonë. Kjo gjë bëhet në kushtet e një klime miqësore në grup, duke kultivuar besimin në grup, ku mendimet e tyre nuk gjykohen, por, në të kundërtën, pranohen dhe mbështeten në rrugën e tyre të ndërgjegjësimit dhe njohjes.

Modulet si element

Edhe pse radha e realizimit të moduleve ju është lënë e lirë, gjë që pasqyrohet edhe në faktin që secili prej tyre nuk ka numër, gjatë realizimit të tyre, për të siguruar një frytshmëri sa më të madhe, është e këshillueshme të zhvillohen me një farë radhe. Edhe pse nuk duam të jemi detyrues, po ju këshillojme një radhë realizimi me ndryshimet e mundshme. Ju lutemi, merrini si këshilla, të cilat kanë dalë gjatë eksperimentimit të moduleve. Jemi të ndërgjegjshëm që ajo që mund të ketë funksionuar shumë mirë në një vend dhe mjedis të caktuar, mund të mos jetë e tillë në kushte të tjera. Këshillat mund t'ju ndihmojnë të kuptoni se ka një proces, nëpërmjet të cilit duhet të kaloni para se të zhvilloni modulet.

Para së gjithash, vlerësoni objektivin kryesor që ju ka shtyrë të përdorni modulet. Cilët janë objektivat që do të ndiqni bashkë me grupin? A janë këta objektiva të rëndësishëm për të përcaktuar radhën e realizimit të moduleve? Pavarësisht nga objektivat, ka një rrjedhë logjike. Moduli "Informacioni kryesor" është shumë i rëndësishëm si hap i parë, pavarësisht radhës së zhvillimit të moduleve të tjera. Është shumë e rëndësishme që para së të vazhdojnë më tej, të rinjtë të njihen me tematikën, faktet dhe të dhënat që karakterizojnë problemin e punës së fëmijëve.

Po kështu, nuk është e këshillueshme të kalohet në modulin e dramatizimit, nëse nuk janë bërë modulet për figurën dhe për lojën me role. Para se të zhvillohet një modul për mjetet e komunikimit, është e këshillueshme që grupi të ketë zhvilluar modulet "Shkrimi krijues" dhe "Kërkimi dhe informacioni". Moduli i debatit duhet të paraprihet nga moduli "Kërkimi dhe informacioni". Modulet duhet të merren si elemente të një strukture, ku disa prej tyre, që të qëndrojnë, duhet të paraprihen nga disa elemente të tjera.

Ndoshta nuk do të ishte një mendim i mirë të fillonit me një module "të vështirë", si, p.sh., "Kërkimi dhe informacioni", që mund ta dekurajojë që në fillim grupin. Nisni me një modul argëtues, si, p.sh., me kolazhin, që e fut grupin në problemtikën e punës së fëmijëve, pa patur nevojë të shfletojë materiale të ndryshme për të marrë informacion.

Më poshtë po ju japin shembuj për të sqaruar idetë për zgjedhjen e moduleve, duke mbajtur parasysh arritjen e objektivave në përputhje me kushtet kulturore, traditat e mjedisit, mundësinë e mjeteve dhe kohën në dispozicion.

Po ju japim shembuj të modifikimeve të ndryshme për radhën e zbatimit, duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme. P.sh., njëri mund të jetë në shërbim të objektivave specifikë të grupit ose në shërbim të kohës apo mjeteve në dispozicion.

Në bazë të objektivave

Dramatizimi i një pjese

Informacioni kryesor për të siguruar një hyrje në problemin e punës së fëmijëve.

Kolazhi për të siguruar një paraqitje vizuale të punës së fëmijëve, për të kapërcyer verbërinë e mjeteve të komunikimit, si dhe për të nxitur grupin të mendojë rreth problemit.

Kërkimi dhe informacioni për të ndihmuar procesin e sensibilizimit.

Figura për të promovuar reagimin emocional ndaj punës së fëmijëve. Të rinjtë fillojnë të ndërtojnë figurën e fëmijës që punon dhe fillojnë të marrin mbi vete përgjegjësi.

Loja me role, vihen në rolin e fëmijëve që punojnë. Të pajisur në këtë moment me një informacion më të detajuar dhe një kuptim më të mirë të problemit të punës së fëmijëve, të rinjtë janë në gjendje të kalojnë në dramatizim.

Shkrimi krijues për të shkruar një skenar apo pjesë rreth punës së fëmijëve. Pasi kanë hedhur hapat e nevojshëm, grupi është në gjendje të krijojë dhe të realizojë një pjesë teatrore.

Integrimi i komunitetit, me këtë modul, synohet t'u jepet mundësi të rinjve të vazhdojnë veprimtarinë e tyre duke i trasmetuar mesazhe të caktuara komunitetit. Kjo është një veprimtari që do ta bëjë grupin të ndihet më i përgjegjshëm. Vetë të rinjtë do të marrin rolin e edukatorëve apo të mësuesit.

Realizimi i një fushate nëpërmjet mjetevet të komunikimit

Informacion kryesor për të patur një informacion bazë për punën e fëmijëve për të hyrë në këtë problem.

Kolazhi për të siguruar një paraqitje vizuale të punës së fëmijëve dhe për të kapërcyer verbërinë e mjeteve të komunikimit me qëllim që grupi të filloj të kuptojë dukurinë.

Kërkimi dhe informacioni për të ndihmuar më shumë procesin e sensibilizimit.

Intervista dhe sondazhe për të ndihmuar procesin e nxënies së metodës të intervistës dhe përpunimit të të dhënave. Ky modul do të thellojë ushtrimin e sensibilizimit.

Shkrimi krijues do të mbështesë konsolidimin e aftësive dhe të njohurive të fituara që janë shumë të rëndësishme për të komunikuar me mjetet e informimit.

Debati (fakultativ) për të përmirësuar më tej modulet e kërkimit dhe të informacionit, si dhe të shkrimit krijues. Gjatë këtij ushtrimi mund të ftohen mjetet e komunikimit dhe në prani të tyre të rinjtë fitojnë njohuri për mënyrën si mund të diskutohet problemi.

Mjetet e komunikimit (shtypi, radioja, televizioni) për të zhvilluar një fushatë për mjetet e komunikimit mbi bazë e të dhënave të marra dhe aftësive të fituara nga modulet e mëparshme.

Paraqitja artistike

Informacion kryesor për të patur një ide fillestare rreth punës së fëmijëve si hyrje për problemin.

Kolazhi për të siguruar një paraqitje vizuale të punës së fëmijëve dhe për të kapërcyesr verbërinë e mjeteve të komunikimit që grupi të filloj të kuptojë domethënien

Kërkimi dhe informacioni për të ndihmuar më shumë procesin e sensibilizimit.

Konkursi artistik për të nxitur paraqitjen artistike të punës së fëmijëve nëpërmjet pikturës dhe skulpturës, si dhe për të shtrirë procesin e sensibilizimit duke zhvilluar një konkurs në komunitet.

Çështja sa kohë ju duhet për të realizuar modulet e SCREAM-it, varet nga objektivat dhe koha që keni në dizpozicion. Kështu, p.sh., nëse programi zhvillohet në një shkollë, mësuesi mund të ketë mundësi t'i kushtojë programit një ose dy orë mësimi në javë. Nëse zhvillohet në kushte joformale, edukatori mund të ketë në dispozicion më shumë kohë. Mësuesi apo edukatori mund të vendosë të punojë në një periudhë të caktuar: katër javë, tre muaj, një semestër apo dhe një vit të tërë shkollor.

Ashtu siç është thënë edhe më sipër, çështja e kohës është themelore, prandaj të merret parasysh para se të fillojë zbatimit i modulit. Duhet të keni të qartë sa kohë do t'i kushtoni procesit pedagogjik dhe arritjes së objektivave të grupit, pavarësisht përbërjes së tij. Modulet kanë nevojë për një sasi të caktuar kohe, të cilën ju vetë do ta manaxhoni në shërbim të asaj që do të arrini.

Burime të mundshme

IPEC-u, qysh në nisjen e programit ishte i ndërgjegjshëm se burimet e informacionit dhe niveli arsimor, ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Ky program mund të zhvillohet si në kushtet e arsimit formal, ashtu dhe në atë joformal. Madje, disa prej moduleve mund të realizohen me shumë pak mjete. Me kalimin e kohës shpresojmë se programi SCREAM do të shtrihet në shumë vende dhe urojmë të marrim nxitës të rinj për realizimin e moduleve të reja, veçanërisht për ato vende që kanë mjete të kufizuara. Është në vëmendjen tonë të përmirësojmë programin SCREAM, nëpërmjet analizës, rishikimit dhe ripërshtatjes së moduleve mbi bazën e përvojës së fituar.

Modulet që kërkojnë mjete të kufizuara:

- Informacioni kryesor
- Shkrimi krijues
- Debati
- Figura
- Loja me role
- Integrimi dhe komuniteti

Shënim:

Moduli i kolazhit mund të zhvillohet me mjete dhe materiale fare të thjeshta dhe te pakushtueshme, por një pjesë e tyre mund të jetë e vështirë të sigurohet.

Gjithësesi, ajo që është e rëndësishme ka të bëjë me aftësitë tuaja përshtatëse. Vetëm ju e dini mirë se çfarë mund t'ju pëlqejë apo do të mund të përshtatet sipas planit tuaj.

Shprehja individuale dhe shprehja e grupit

Gjatë realizimit të programit SCREAM, të rinjtë duhet të ndihen të lirë të shprehim mendimet e tyre në grup. Pjesa më e madhe e emocioneve të tyre do të shprehet në module të ndryshme nëpërmjet shkrimit krijues, dramatizimit, artit etj. Por, gjithashtu, është e rëndësishme të kuptojnë si programi ka ndikuar tek secili prej tyre dhe në të gjithë grupin.

Rrugët që mund të zgjidhen, janë të ndryshme, por do të dëshironim që mësuesit dhe edukatorët të zgjidhnin rrugët më të frytshme në përshtatje me kulturën, traditat dhe pengesat e mjedisit.

Ditari vetjak

Qysh në fillim të programit edukatori mund t'u kërkojë të rinjve të grupit të mbajnë një ditar vetjak. Hidheni këtë ide që në takimet e para. Diskutoni rëndësinë që ka eksperimentimi i programit, ndikimi i tij tek të rinjtë dhe rëndësinë që ka ndarja e përvojës që do të fitojnë me organizata të tjera, si IPEC. Gjithashtu veçoni faktin se ditari do t'u japë ndihmë të gjithëve: të rinjve, edukatorëve, komunitetit të vlerësojnë se çfarë kanë përfituar nga programi.

Në ditar anëtarët mund të shkruajnë rreth përshtypjeve që kanë për procesin, për temat e trajtuara, për emocionet që kanë përjetuar. Mund të shkruajnë për çështje e trajtime që u kanë pëlqyer ose jo, duke shprehur edhe mendimin e tyre për ndryshime apo përmirësime që mund të bëhen. Mund të krijojnë një farë inventari të të gjitha veprimtarive, të emocioneve që lidhen me to, si dhe të veçojnë ndihmesën që ata mendojnë se kanë sjellë në zhvillimin e modulit.

Ditari do t'i ndihmojë të rinjtë të shprehin vlerësimin e tyre për programin, veçanërisht në rastet kur programi ka patur një shtrirje të ndjeshme në kohë.

Ditari i grupit

Ditari i grupit mund të jetë një mbështetje apo vazhdim i ditarit vetjak, madje edhe në rastet kur të rinjtë nuk dëshirojnë të mbajnë ditar të vetin. Kjo ide mund të dalë veçanërisht e dobishme në ato vend ku është problem analfabetizmi.

Ditari i grupit mund të vlerësohet si një ushtrim i përditshëm që zhvillohet në grup. Meqë bëhet fjalë për një ditar grupi, është mirë që të gjithë, herë pas here, të marrin pjesë në shkrimin e tij. Nëse shkruhet në përfundim të një veprimtarie, do të ishte mirë të ishte pjesë e diskutimit përfundimtar të veprimtarisë. Mund të merret edhe si pjesë e veprimtarisë ku shkëmbehen ide, mendime, përshtypje dhe emocione të përftuara gjatë realizimit të modulit. Në këto raste, për të shkruar përfundimet e këtij procesi, gjithmonë duhet të zgjidhni një person përgjegjës (jo të njëjtin), mirë është që të jetë vullnetar. Në rastet kur nuk ka vullnetar, ju vetë mund të merrni rolin e shkruesit të ditarit.

Vlen t'ju kujtojmë se pjesëmarrja juaj gjatë shkëmbimit të ideve në një farë mase mund të zbehë shprehjen e përshtypjeve. Nëse e vëreni këtë gjë, është mirë t'i lini të rinjtë për 15 minuta vetëm që të zhvillojnë seancën e shkëmbimit të ideve. Ky akt besimi do të forcojë lidhjet brenda grupit. Nxitini të rinjtë të jenë të hapur dhe këshillojeni personin e ngarkuar të marrë në shënim gjithçka që thuhet, pozitive ose negative. Gjithashtu, shpjegoni konceptin e "kritikës konstruktive", që do të thotë që edhe për ato pjesë të modulit që nuk paraqesin interes, jo vetëm të shprehin, por dhe të shpjegojnë psenë, duke paraqitur alternativa si mund të zhvillohet moduli. Këto ditare mund t'i dërgoni në IPEC dhe ne do të jemi të lumtur të lexojmë komentet dhe mendimet e të rinjve.

Një formë tjetër shumë interesante do të ishte ditari i ndjenjave që mund të paraqitet në formën e një muraleje. Kjo mënyrë nxit përgjigje pozitive nga ana e të rinjve, pasi shkrimet, vizatimet murale janë shprehje të rastësishme dhe pa kufizime që mbështesin veprimtarinë krijuese të të rinjve, duke realizuar kështu një ndër objektivat e moduleve.

Ideja është që në klasë apo në mjedisin ku mblidhet grupi, të ketë një letër të bardhë të ngjitur në mur (që mund të hiqet në fund të takimit nëse të tjerë e përdorin mjedisin). Letra duhet të mbulojë pjesën më të madhe të murit. Nëse është e mundshme, siguroni një letër me ngjyrë dhe ngjiteni.

Në seancën e parë të fillimit të modulit, ngjisni në mur një letër të pastër. Shpjegojini grupit përse duhet letra. I riu më i talentuar i grupit, të cilit i vjen dorësh të vizatojë, do të shkruajë titullin e modulit. Kjo letër do të shërbejë si vendi ku të rinjtë e grupit do të shkruajnë, në çdo kohë, çdoj mendim, ndjenjë apo dhe vlerësim që kanë në lidhje me modulin. Lërini të lirë të shkruajnë, të vizatojnë, të ngjisin figura sipas dëshirës. Ata duhet të ndjejnë se faqja e murit e mbuluar me letër jo vetëm që është pronë e tyre, por dhe përgjegjësia e tyre. Pra, ata duhet të kujdesen që persona të tjerë, brenda dhe jashtë grupit, të mos e prishin. Kështu, nëse do t'u vinte diçka në mendje, gjatë një ushtrimi, p.sh., duke parë fotografi të fëmijëve që punojnë, dhe nëse do të dëshironin të shprehnin emocionet e tyre pikërisht në këtë kohë, lërini të shkojnë dhe t'i shkruajnë këto në letrën e murit. Kujdesuni që të ketë gjithmonë laps për të shkruar.

Në këtë letër mund të shkruajnë parrulla, tema, fjalë apo fjali të rëndësishme. Mund të ngjisin në të figura që paraqesin dhunimin e të drejtave të fëmijëve apo figura që i promovojnë këto të drejta. Mund të vizatojnë figura që shprehin solidaritet, frikë, dhimbje, dashuri. Ftojini të lexojnë poezi apo gjeni të tjera, shkrime letrare dhe përpiquni të gjeni pjesën që lidhet dhe është e rëndësishme për mesazhin që jep në lidhje me projektin. Ose, edhe më mirë, mund të shkruajnë një poezi apo prozë të krijuar nga ata vetë.

Nxitini të rinjtë të ftojnë vizitorë të shkruajnë diçka në mur. Nëse anëtarë të komunitetit ftohen të marrin pjesë në seksionet e modulit, edhe këta mund të lënë përshtypjet apo shënimet e tyre në mur.

Fillimisht do t'ju duket se grupi nuk do të ndihmojë aq sa duhet. Por, me kalimin e kohës, veçanërisht pas realizimit të moduleve që rrisin përgjegjësinë e grupit, si, p.sh., pas modulit të krijimtarisë së shkruar, do të vëreni së fëmijët të qetë dhe lehtësisht do të marrin pjesë. Në fillim të seancave, tërhiqni vëmendjen e fëmijëve ndaj letrës në mur që pret të mbushet. Nxirrni në pah vlerat veprimeve të para apo shkrimet e para. Së fundi, mund të ndodhë që ta keni mbushur plot fletën e parë dhe ju duhet të vendosni një fletë të dytë.

Ruajni muralet deri në përfundim të projektit. Ato janë një element shumë i vlefshëm, pasi dëshmojnë rrugën e përshkruar nga grupi. Në IPEC do të jemi shumë të kënaqur të kemi modele të tyre nga e gjithë bota.